



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 26.10.2016

PËR

**MIRATIMIN E LEJES, "PËR PËRDORIM BURIMI UJOR",  
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC-ET "BIGAS 1",  
"BIGAS 2", "VELESHNJË", ME VENDNDODHIJE NË PELLGJET  
UJËMBLEDHËS TË PËRRENJVE BIGAS DHE VELESHNJË, NË  
NJËSITË ADMINISTRATIVE POTOM, ÇEPAN, BASHKIA SKRAPAR,  
QARKU BERAT**

Në mbështetje të shkronjës "ç", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore", me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, "Për përdorim burimi ujqor", për prodhim hidroenergjie, shoqërisë "HP Bigas dhe Veleshnjë", sh.p.k., për HEC-et "Bigas 1", "Bigas 2", "Veleshnjë", me vendndodhje në pellgjet ujëmbledhës të përrenjve Bigas dhe Veleshnjë, në njësitë administrative Potom, Çepan, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I  
E D I R A M A

Në mungesë  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
NIKO PELESHI

